

20051131565

L I G J
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT
PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE INVALIDË

Neni 1

Në Ligjin për punësimin e personave invalidë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 44/2000, 16/2004 dhe 62/2005), në nenin 4-a paragrafi 1 fjalët: ”edhe pse nuk ka vlerësimin e aftësisë punuese të Komisionit nga neni 2 paragrafi 3 të këtij ligji se mund t’i kryejë punët në vendin përkatës të punës” fshihen.

Pas paragrafit 1 shtohen tre paragrafë të rinj 2, 3 dhe 4, si vijon:

“Punët të cilat mund t’i kryejë personi invalid në vendin përkatës të punës, i përcakton Komisioni pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, të cilin me akt e formon ministri i Punës dhe Politikës Sociale, i cili përcakton edhe përbërjen e Komisionit.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale përcakton me akt mënyrën për miratimin e Ekspertizës dhe mendimit të Komisionit nga paragrafi 2 i këtij neni.

Mjetet për punën e Komisionit nga paragrafi 2 të këtij neni sigurohen prej Fondit të veçantë nga neni 15 paragrafi 1 të këtij ligji.”

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 5 fjalët: “neni 2 paragrafi 3” zëvendësohen me fjalët: “neni 4-a paragrafi 2”.

Neni 2

Në nenin 11 pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri, si vijon:

“Bashkësia nga paragrafi 1 të këtij neni i kryen punët administrative dhe mban evidencë për Ekspertizat e mendimet e dhëna të Komisionit nga neni 4-a paragrafi 2 të këtij ligji.”

Neni 3

Në nenin 15 pas paragrafit 1 shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3 si vijojnë: “Mjetet e pashfrytëzuara nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia mund t’i shfrytëzojë për financimin e masave për punësimin e personave të papunë të evidentuar.

Vendim për shfrytëzimin e mjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Agjencisë”.

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 4 pas fjalëve: “paragrafi 1” shtohen fjalët: “dhe paragrafi 2”.

Paragrafi 3 bëhet paragraf 5.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.